



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2020:168132

Datë: 07.09.2022

Numri i dokumentit: 03396259

**PPP.nr.99/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM CIVIL**, me gjyqtarin Shemsedin Haxhiaj, në çështjen juridike - përmbarimore të kreditorit I.D nga fshati V. Komuna Istog, në bazë të dokumentit përmbarimor Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog C.nr.139/16, i datës 29.09.2017 dhe i plotfuqishëm me datë 15.06.2020, baza juridike borxh në vlerë prej 630,00 euro, caktuar me Urdhrin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat F.Sh P.nr.1092/20 të datës 20.11.2020, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit M.D nga fshati V. Komuna Istog, jashtë seancës gjyqësore me datë 06.09.2022 nxjerri këtë:

**AKVENDIM**

**I. REFUZOHET NË TERËSI SI I PABAZUAR**, prapësimi i debitorit M.D nga fshati V. Komuna Istog, i parashtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat F.Sh P.nr.1092/20 të datës 20.11.2020.

**II.** Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi e ndalon përmbarimin.

**ARSYETIM**

Kreditori I.D nga fshati V. K.Istog, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në Gjykatën Themelore në Pejë, ndaj debitorit M.D nga fshati V. K.Istog, në bazë të dokumentit përmbarimor Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë Dega Istog C.nr.139/16, i datës 29.09.2017 dhe i plotfuqishëm me datë 15.06.2020, për shkak të bazës juridike borxh në vlerë prej 630,00 euro.

Përmbaruesit Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin për përmbarim P.nr.1092/20 të datës 20.11.2020.

Debitori në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor me datën 26.11.2020 duke theksuar se: urdhëri për përmbarim ka shkelje të dispozitave lidhur me

nenin 17, 71 par.1.1, neni 22, 27 dhe neni 36 të LPP-së, me aktgjykimin me të cilën është nxjerr urdhëri mbi lejueshmërinë përmbartimit nuk është caktuar asnjë detyrim për ndonjë prestim të caktuar, dhe nuk e përmban klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri, duke propozuar që urdhëri për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit Privat F.Sh P.nr.1092/20 të datës 20.11.2020, të anulohen të gjitha veprimet përmbartimore ose procedura përmbartimore të pezullohet.

Gjykata në procedurë përmbartimore pas shqyrtimit dhe vlerësimit të prapësimit të debitorit, si dhe shkresave tjera të lëndës konstatoj se i njëjti nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, në bazë të të cilave shkaqe gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Gjykata prapësimin e debitorit M.D nga fshati V. K.Istog, e refuzoi si të pabazuar, duke ju referuar dokumentit përmbartimor përkatësisht Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Istog C.nr.139/16, i datës 29.09.2017 dhe i plotfuqishëm me datë 15.06.2020, me të cilin detyrohet pala debitore që ta paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 630,00 €, e po ashtu duke ju referuar dispozitave ligjore të neni 24 të LPP-së i cili përcakton se: vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e borxhit për mosveprim ose veprim është i pambarueshëm po që se është i formës së prerë, prandaj në rastin konkret dokumenti përmbartimor në bazë të cilit është lejuar përmbartimi është i plotfuqishëm, dispozitivi i tij i përshtatshëm dhe i pambarueshëm, dhe i përcaktuar qartë detyrimi i palës debitore ndaj kreditorit.

Gjykata vendosi si në pikën një të dispozitivit të këtij aktvendimi duke ju referuar edhe parimit të legalitetit rigoroz formal, ku gjykata në procedurë përmbartimore nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë materiale dhe të rregullsisë së dokumentit përmbartimor (titullit ekzekutiv), në bazë të të cilit e lejon përmbartimin, ngase në procedurë civile nuk lejohet gjykim i ri midis palëve të njëjta për çështjen juridike për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë.

Gjykata vendosi si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktvendimi konformë neni 127 të LPP-së i cili përcakton se aktvendimi apo urdhri për kalimin e borxhit nxirret vetëm pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi apo urdhri për sekuestrimin, konformë neni 74 par. 3 i cili përcakton se vendimi me të cilin refuzohet prapësimi bëhet i formës së prerë, po që se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa refuzohet si e pathemeltë dhe neni 166 i cili përcakton se procedurën e përmbartimit për kredinë sipas llogarisë në bankë, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e këtij ligji për përmbartimin për kredinë në të holla të debitorit nga nenet 109 – 141 të këtij ligji .

Po ashtu gjykata i refuzoj kërkesën e debitorit për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit, duke ju referuar dispozitave ligjore të neni 54 par. 1 pika 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbartimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbartimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbartimit, në qoftë se

dokumenti përmbare me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, konformë dispozitave ligjore të nenit 67 par.1 pika 1, nenit 71, dhe nenit 73 par.3 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHEM CIVIL**  
**PPP.nr.99/20, datë 06.09.2022**

**Gj y q t a r i**  
**Shemsedin Haxhijaj**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate